



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
NË DREJTIMIN “SHËRBIM MJETESH TRANSPORTI”, NIVELI I

TIRANË, 2015

Programi orientues për provimet përfundimtare të drejtimit mësimor ”**Shërbim mjetesh transporti**”, **Niveli I** përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme

dhe më përfaqësuese për këtë drejtim mësimor, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në të dy klasat e këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për prindërit, ky program jep informacionin për vëllimin e punës që kërkohet të bëjnë fëmijët e tyre dhe ndihmon në caktimin e një regjimi të përshtatshëm ditor për ta.

Për drejtuesit e arsimit profesional të të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste teorike apo praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në drejtimin mësimor "Shërbim mjetesh transporti", Niveli I është hartuar duke u mbështetur në programet e përgjithshme të lëndëve profesionale, që përmban Skelet-kurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 40% të vëllimit të orëve të lëndëve profesionale, për të dyja klasat e marra së bashku (klasa e 10-të dhe klasa e 11-të).

Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	48	18
2	Njohuri për mjetet e transportit	108	41
3	Shërbime mjetesh transporti	76	29
4	Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit	30	12
	TOTALI	262	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) Temat nga lënda “**Bazat e mekanikës për mjetet e transportit**”, kl. 10 dhe 11:

- Vetitë fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike të materialeve
- Materialet metalike
- Lidhjet e metaleve
- Mekanizmat tipike të makinave
- Transmisionet (sistemet) tipike të makinave
- Llogaritje të thjeshta për statikën, kinematikën dhe dinamikën
- Shtypja, tërheqja, përkulja, përdredhja dhe prerja
- Ngarkesat e kombinuara
- Përpunimi me prerje
- Përpunimi me saldim dhe ngjitje
- Përpunimi me heqje ashkle
- Përpunimi axhusterik
- Saktësia e punimit. Kuptimi dhe llojet e tolerancave të përmasave
- Saktësia dhe ashpërsia e sipërfaqeve të detaleve

b) Temat nga lënda “**Njohuri për mjetet e transportit**”, kl.10 dhe 11 :

- Sistemet kryesore të mjeteve të transportit
- Sistemi i ndezjes së MDB
- Sistemi i ftohjes së MDB
- Sistemi i vajtjes së MDB
- Sistemi i ushqimit me injeksion të benzinës
- Sistemi i ushqimit me injeksion të naftës
- Burimet e energjisë elektrike në mjete transporti
- Sistemi i lëshimit të motorit
- Freksionet e mjeteve të transportit
- Kutitë e shpejtësive në mjetet e transportit
- Rrotat e automjeteve
- Sistemet e drejtimit të mjeteve të transportit

- Sistemet e frenimit të mjeteve të transportit

c) Temat nga lënda “**Shërbime mjetesh transporti**”, kl.10 dhe 11 :

- Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi automjetesh
- Llojet dhe përshkrimi i dëmtimeve të detaleve dhe nyjeve në makina
- Konsumimi dhe vajisja e detaleve dhe nyjeve të makinave
- Metodatat e riparimit të detaleve të makinave
- Shërbimet e mirëmbajtjes në motorët e mjeteve të transportit
- Punime të zëvendësimit në sistemin e vajisjes së motorit
- Punime të zëvendësimit në sistemin e ftohjes së motorit
- Punime të zëvendësimit në sistemin e ushqimit të motorit
- Punime të zëvendësimit në burimet e energjisë elektrike
- Punime të zëvendësimit në sistemin e ndezjes së motorit
- Punime të zëvendësimit në sistemin e lëshimit të motorit
- Shërbimet e mirëmbajtjes në transmisionet e mjeteve të transportit
- Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet e drejtimit dhe frenimit të automjeteve
- Punime të zëvendësimit në sistemet e drejtimit të automjeteve
- Punime të zëvendësimit në sistemet e frenimit të automjeteve
- Punime të zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve

d) Temat nga lënda “**Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit**”, kl. 11:

- Madhësitë elektrike dhe matja e tyre
- Efektet e rrymës elektrike
- Rreziqet dhe mbrojtja nga rryma elektrike
- Elementet (simbolet) dhe llojet kryesore të skemave elektrike
- Ndriçuesit dhe sinjalizuesit
- Pajisjet mbrojtëse (siguresat dhe automatët)
- Pajisjet e komutimit, komandimit dhe rregullimit
- Gjysëmperçuesit
- Elementet e qarqeve elektronike
- Skemat bazë me gjysmëperçues

Udhëzime për vlerësimin:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me shkrim. Rekomandohet që provimi të kryhet me anë të një testi të parapërgatitur nga vetë shkolla. Gjithashtu, rekomandohet që 50% e njësive të testit të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (deri në 4 alternativa) dhe pjesa tjetër të jenë njësi testi në formën e pyetjeve me përgjigje të hapur (nxënësi duhet të japë edhe argumentet për përgjigjen e dhënë nga ana e tij/saj), pyetje me përgjigje të kufizuar etj.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Niveli I: Rikujtimi / Të kuptuarit
Niveli II: Zbatimi / Analiza
Niveli III: Sintetza/ Vlerësimi

Shkolla përcakton numrin maksimal të pikëve të testit dhe harton skemën përkatëse të vlerësimit. Në tabelën në vijim, rekomandohet që numri maksimal i pikëve të jetë 50 dhe shpërndarja e pikëve të bëhet në raport me peshën e çdo lënde dhe nivelet e vështirësisë.

Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	18	9	4	4	1
2	Njohuri për mjetet e transportit	41	20	8	8	4
3	Shërbime mjetesh transportit	29	15	6	6	3
4	Elektroteknika dhe elektronika në automjete	12	6	2	2	2
	TOTALI	100%	50 pikë	20 pikë	20 pikë	10 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Kështu, njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë, por mund të marrin edhe 2 (dy) pikë nëse përmbajnë jo thjesht rikujtim por edhe analizë dhe llogaritje; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda për brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar dhe llojet e tjera të njësive të përfshira në test, marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 20	4
21 - 25	5
26 - 30	6
31 - 35	7
36 - 40	8

41 - 45	9
46 - 50	10

B. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në drejtimin mësimor "Shërbim mjetesh transporti", Niveli I është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skelet-kurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, postet e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Posti i punës	Pikët
1	Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për shërbime mjetesh transporti	Në të gjitha postet	5
2	Të kryejë matje dhe kontrole të sakta, të nevojshme për shërbime mjetesh transporti	Në të gjitha postet	5
3	Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit	Në të gjitha postet	10
4	Të kryejë punime të zëvendësimit në njërin nga sistemet e motorit me djegie të brendëshme (sistemit të vajisjes, të ftohjes, të ushqimit, të ndezjes ose të lëshimit)	1-Punime në sistemet e motorit	25
5	Të kryejë punime të zëvendësimit në njërin nga mekanizmat e motorit me djegie të brendëshme (mekanizmit biellë-manivelë ose mekanizmit të shpërndarjes së gazeve)	2-Punime në mekanizmat e motorit	20
6	Të kryejë punime të zëvendësimit në njërin nga agregatet e transmesionit të fuqisë së automjeteve të lehta (frikSION, kuti shpejtësie, transmision kardanik, transmision kryesor dhe gjysëmboshte).	3-Punime në transmisionin e fuqisë	15
7	Të kryejë punime të riparimit, zëvendësimit dhe ballancimit të rrotave të automjeteve të lehta.	4-Punime në rrota	10
8	Të kryejë punime të zëvendësimit të pjesëve në sistemin elektrik dhe elektronik të automjeteve të lehta.	5-Punime në automjet	10
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve “***me rotacion në disa poste pune***” (në tabelën e parë tregohen 5 postet e punës).
- Nxënësit do të vlerësohen për 8 kompetenca bazë, ku 3 kompetencat e para janë kros-profesionale dhe verifikohen gjatë kryerjes së punimeve në 5 kompetencat e tjera.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësim edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.